Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

Data 29.11.2024 Vendi Kaçanik
Nj. org. Numri Shtojcë
01-104/02-30057/24

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

Kaçanik, 29.11.2024

Duke u bazuar në nenin 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të komunës së Kaçanikut, pas propozimit dhe konsultimit me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, në kuadër të drejtave dhe përgjegjësive si Zyrtar Kryesor Administrativ, kryetari i komunës nxjerr këtë:

# VENDIM

## Për lejimin e mjeteve financiare për Hapjen- zgjerimin dhe ndërtimin e rrugës rurale " Shkelzen Haradinaj"në fshatin Runjevë lagja Krivenjevë të Komunën së Kaçanikut

I. Me këtë vendim lejohen mjetet buxhetore për rregullimin dhe ndërtimin e rrugës Rurale "Shkelzen Haradinaj"në fshatin Runjevë lagja Krivenjevë në Komunën e Kaçanikut, të kontratë me nr. **652-24-26-15-5-2-1 KA652-024-018-5-2-1 e dates 14.06.2024**

1. Rruga "Shkelzen Haradinaj"në fshatin Runjevë ( Lagja Krivenjevë)

II. Mjetet buxhetore nga pika 1 e këtij vendimi do të ndahen nga kategoria buxhetore "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve Rurale", kontrat njëvjeqare nga Programi Buxhetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

III. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

IV. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:*

1. *Kryetari i komunës*
2. *Drejtoria për Financa dhe Ekonomi dhe*
3. *Arkivi komunal.*

Besim Ilazi

Kryetar i komunës

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
**Komuna e Kaçanikut**
Opština Kačanik/Municipality of Kaçanik
**Zyra e Kryetarit**

KAÇANIKU

01Nr. 104/02-296599/24
Kaçanik; 25.11.2024

Në mbështetje të nenit 21, 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. **Aprovohet** si e bazuar kërkesa për qasje të plotë në dokumente publike dhe informacion nga Rrjeti i Organizatave Joqeveritare AVONET, ref:489/2024 –lidhur me Listen e plotë të mësimdhënësve të punësuar me kontratë të përkohshme gjatë periudhes shkollore 2020-2024 si dhe informacion rreth rregullatives ligjore që është përdorur për emërimin/caktimin/ përzgjedhjen e mësimdhënësve me kontratë të përkohshme
2. Lista e mësimdhënësve me kontratë të përkohshme gjatë periudhes 2020-2024 dhe informata rreth rregullatives ligjore gjate zhvllimit të procedures mund t'iu ofrohet palës kërkuese nga Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

## Arsyetim

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, më 18 nëntor 2024, kemi pranuar një kërkesë nga z. Lorik Krasniqi-Zëvendës Drejtor Ekzekutiv në Rrejti i OJQ-ve AVONET, për qasje në dokumente publike dhe informacion në lidhje me mësimdhënësit e punësuar me kontratë të përkohshme gjatë periudhes shkollore 2020-2024 si dhe informacion rreth rregullatives ligjore që është përdorur për emërimin/caktimin/ përzgjedhjen e mësimdhënësve me kontratë të përkohshme
Kryetari i Komunës, pas shqyrtimin të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të saj, bazuar në kompetencën e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:**
Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, përmes zyrtarit për QDP, mund të paraqesë ankesë në Shtyllën për Qasje në Dokumente Publike të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, brenda 7 (shtatë) ditësh nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Kryetari i Komunës
z. Besim Nazi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

Vendimi i dërgohet:
- z.Lorik Krasniqi
- Njësisë/Zyrtarit për QDP
- Arkivit të Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

*01Nr.* 104/02-29426/24
*Kaçanik,* 20.11.2024

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Kaçanikut 01 Nr.60/01-12895/20 nenin 78 pika 6, Rregulloren për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 02-04/02-26493/20, Rregullores për Taksat Komunale 01Nr.02-60/01-4863/20 e ndryshuar me Rregulloren 01Nr.07-60/01-25563/22 datë 29.09.20 dhe Shpalljes Publike 07–104/02-28178/24 të dt. 06.11.2023 Për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e parkingjeve publike në bulevardin "Ismal Raka"- Kaçanik, pas propozimit të drejtorit të drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, kryetari i komunës nxjerr këtë:

**VENDIM**
**Për formimin e komisionit të përkohshëm**

**I.** Me këtë vendim formohet komisioni i përkohshëm, i cili do të bëj hapjen dhe vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e parkingjeve publike në bulevardin "Ismal Raka"- Kaçanik,

**II.** Komisioni komunal ka për detyrë të shqyrtoj ofertat e operatorëve ekonomik duke u bazuar në Shpalljen Publike 07–104/02-28178/24 të dt. 06.11.2024 Për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e parkingjeve publike në bulevardin "Ismal Raka"- Kaçanik dhe të bëj përzgjedhjen e ofertuesit, bazuar kritereve të Shpalljes Publike.

**III.** Komisioni komunal për shqyrtimin, verifikimin dhe përzgjedhjen e operatorit ekonomik, do të jetë me këtë përbërje:

1. Eljesa Begunca– zyrtar për hapësira publike,
2. Kaltrina Guri– zyrtare ligjore dhe
3. Bujar Bajra – zyrtar i lartë për emergjenca.

**IV.** Komisioni obligohet që menjëherë të filloj punën dhe me raport me shkrim për punën e vet të njoftoj zyrën e kryetarit.

**V.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**VI.** Me këtë vendim, njoftohen: Anëtarët e Komisionit dhe Arkivi.

Besim Ilazi

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA